

Njoftim për Grimcat e të Dhënave (Cookies) dhe Informacionet Analitike në Internet

Me këtë Njoftim për Grimcat e të Dhënave (Cookies), dëshirojmë t'ju informojmë mbi mënyrën se si ne në Trans Adriatic Pipeline AG (më poshtë "TAP" ose "ne" ose "neve") përdorim grimcat e të dhënave në Faqen tonë të internetit www.tap-ag.com (më poshtë "Faqja e Internetit").

Ne mbledhim të dhëna jo personale lidhur me përdorimin e Faqes sonë të Internetit për qëllime të sigurisë së të dhënave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përdorimit të faqes. Këto të dhëna të mbledhura automatikisht nuk kombinohen me burime të tjera të dhënash.

1. Grimcat

Ne përdorim të ashtuquajturat grimca të dhënash në pjesën e lundrimit në internet. Grimcat e të dhënave nuk dëmtojnë kompjuterin tuaj, ato janë dokumente të vogla me parametrat e konfigurimit që na ndihmojnë ta bëjmë Faqen tonë më miqësore për përdoruesin, më të efektshme dhe më të sigurt. Grimcat e të dhënave përdoren edhe për të zbatuar disa funksione të përdoruesit.

Faqja jonë e Internetit përdor "grimca seancash", që fshihen automatikisht pas mbylljes së programit të lundrimit në internet, si dhe "grimca të qëndrueshme", që mbeten në pajisjen tuaj fundore derisa ato arrijnë momentin e skadimit, ose derisa fshihen manualisht nga ju. Këto të fundit janë "Grimca të Palëve të Treta" që arrijnë të njohin programin tuaj të lundrimit herën e ardhshme që vizitoni. Detajet për "Grimcat e Palëve të Treta", pra grimcat e të dhënave nga palët e treta ofruese, si Google Inc. mund të gjenden në politikat përkatëse të privatësisë.

Ju mund të zgjidhni programin e lundrimit ose parametrat e privatësisë për pajisjen tuaj, në mënyrë që të informoheni mbi përcaktimet e grimcave të të dhënave dhe t'i lejoni këto grimca vetëm në raste individuale. Gjithashtu, ju mund të refuzoni pranimin e këtyre grimcave për disa raste ose në përgjithësi, dhe të aktivizoni fshirjen automatike të tyre kur mbyllni programin e lundrimit. Megjithatë, nëse grimcat çaktivizohen, është e mundur që ju të mos keni mundësi të përdorni të gjitha funksionet e Faqes sonë të Internetit.

2. Analiza në Internet

Në mënyrë që të përmirësojmë vazhdueshëm përdorueshmërinë dhe funksionet e Faqes sonë të Internetit, ne përdorim mjete analizuese dhe Google Analytics të përshkruara si më poshtë. Për këto qëllime, mbledhen vetëm të dhëna jo personale.

Google Analytics: Google Analytics e Google Inc, 1600 Amphitheatre Parkway Mountain View, CA 94043, SHBA përdor të ashtuquajturat "grimca", dokumente tekstore të ruajtura në kompjuterin tuaj dhe që mundësojnë analizimin e sjelljes tuaj naviguese në Faqen tonë të Internetit. Informacioni i mbledhur nga grimca rreth sjelljes suaj si përdorues, zakonisht transferohet në një server të Google-it në SHBA dhe ruhet atje. Megjithatë, nëse anonimiteti i IP-së është aktivizuar në këtë Faqe Interneti, Google do ta reduktojë adresën tuaj IP paraprakisht në atë të Vendeve Anëtare të BE-së ose në vende të tjera palë të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane. Vetëm në raste të veçanta adresa e plotë IP i transmetohet serverit të Google-it në SHBA dhe më pas shkurtrohet atje. Google e përdor këtë informacion për të vlerësuar përdorimin e Shërbimit, për të hartuar raporte mbi këto veprimtari dhe për t'i ofruar Operatorit të faqes së internetit informacion shtesë lidhur me përdorimin e Faqes dhe të Internetit. Adresa IP e transmetuar nga programi juaj i lundrimit në kontekstin e Google Analytics nuk përzihet me të dhëna të tjera të Google. Ju mund të refuzoni përdorimin e grimcave duke zgjedhur parametrat përkatës në programin tuaj të lundrimit, megjithatë ju lutemi të vini re se nëse e bëni këtë, ju mund të mos keni mundësi të përdorni të gjitha funksionet e Faqes tonë të Internetit (<http://tools.google.com/dlpage/gaoptout?hl=en>). Më tepër informacion mbi termat e përdorimit dhe mbrojtjen e të dhënave në lidhje me Google Analytics mund të gjenden në <https://www.google.at/analytics/terms/de.html>

3. Grimca që përdoren nga Faqja e Internetit

Grimcat e mëposhtme të të dhënave përdoren nga Faqja e Internetit:

Grimcat e nevojshme: grimcat e nevojshme ndihmojnë që një faqe interneti të përdoret duke aktivizuar funksione bazë si navigimi i faqeve dhe qasja në zonat e sigurta të internetit. Faqja e internetit nuk mund të funksionojë siç duhet pa këto grimca. Faqja e internetit përdor grimca JSESSIONID dhe PHPSESSID.

Grimca funksionale: këto janë grimca statistikore që ndihmojnë pronarët e faqeve të internetit të kuptojnë se si vizitorët bashkëveprojnë me faqet e internetit duke mbledhur dhe raportuar informacion në mënyrë anonime. Faqja jonë e internetit përdor grimca statistikore "_ga", "_gat", "_gid" dhe "collect".

4. Mirëkuptimi për të përdorur grimcat

Duke përdorur faqen tonë të internetit, ju pëlqeni përpunimin e të dhënave tuaja në mënyrën dhe qëllimet e përcaktuara më lart.

5. Ndryshime në përdorimin e grimcave

Çdo ndryshim në përdorimin e grimcave për këtë Faqe Interneti do të shënohet këtu dhe nëse është e nevojshme, shenjat e faqeve do të theksojnë çdo ndryshim.

6. Kontakte për Informacion

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë njoftim, ju lutemi na kontaktoni në dpo@tap-ag.com